

EPPC Albania kërkon një **Menaxher i Departamentit të Burimeve Njerëzore** për klientin e saj, një ndër kompanitë më të mëdha e të konsoliduara në vend dhe rajon.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Dizenjon, formulon, rishikon dhe rekomandon politikat dhe objektivat e BNJ për kompaninë;
- Kontrollon implementimin e programeve të BNJ për stafin;
- Përgjegjës për hartimin, zbatimin e strategjive të zhvillimit të stafit, duke përfshirë vlerësimin e performancës, trajnimin dhe zhvillimin e stafit, promovimet dhe strategjitë e vazhdimësisë për pozicionet kyçe;
- Menaxhon stafin e Departamentit – trajnon personelin e ri nën mbikqyrjen e tij/saj;
- Mban kontakte të ngushta me autoritetet ligjore/shtetërore dhe palët kyçe të interesit për Burimet Njerëzore, çështjet që i shërbejnë interesit më të mirë të operacioneve të kompanisë në selinë qendrore dhe njësitë e biznesit;
- Dizenjon dhe mundëson praktikatat më të mira përsa i përket elementeve të pagës, duke përfshirë kompensimet, benefitet, skemën e sigurimeve dhe paketat e tjera të ngjashme;
- Menaxhon buxhetin e departamentit të BNJ;
- Siguron delegimin efektiv të detyrave sa herë është e nevojshme tek stafi direkt që ka në varësi.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Shkenca Ekonomike/Shkenca Sociale/Juridike etj;
- **Përvojë e mëparshme e konsoliduar në pozicione drejtuese në BNJ;**
- **Të zotërojë shumë mirë gjuhën Angleze;**
- Përvojë në hartimin e programeve të rekrutimit, kompensimit dhe përfitimeve, zhvillimit të stafit;
- Aftësi drejtuese, organizative dhe vendimmarrëse.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.